



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1168 /2021
Data: 16.02.2021

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e parë -I- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28.01.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Besiane Thaçi (Kryesuese e Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Propozim vendim për ndarjen e bursave për studentë.
4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2021.
5. Plani i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021.
6. Informatë mbi veprimtaritë e subjekteve afariste për vitin 2020.
7. Shfuqizimi i vendimit me numër 01/Nr.9228/2020 për ndërrim destinim të pronës.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç këtyre pikave të rendit të punës ekzekutivi ka kërkuar që të procedohet edhe një pikë shtesë të cilën e kemi përcjell ndër kohë, për shkak se Ministria e Pushtetit Lokal ka kërkuar që të rishqyrtohet rregullorja për taksa komunale për vitin 2021. Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- për çdo vit përcaktohen pikat e rendit të ditës për planet e komiteteve konsultative dhe për çdo vit kam dhënë vërejtjet e mia dhe nuk është përmirësuar asnjë. Pika e cila është propozuar për diskutim në këtë rend të punës plani i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021, mendoj që nuk është i bazuar në ligj, në statut dhe në rregullore të komunës. Unë propozoj edhe një pikë të rendit të punës rreth komiteteve konsultative. Kërkoj që të formohet një komitet konsultativ për pronë komunale.

Kryesuesi thekson:- ftes ju kam dërguar komiteteve konsultative dhe komitetit për komunitet që të jenë pjesëmarrës në mbledhje të kuvendit sepse nëse ka ndonjë vërejtje apo propozim nga asambleja komunale kryesuesit e komiteteve me i dhënë sqarimet, por prezent e kemi vetëm një kryesuese nga komitete konsultative. Sa i përket kompetencave anëtarët e komitetit kanë të drejtë me propozuar vetë pika të rendit të punës dhe nuk mendoj që janë jashtë kompetencave. Ju e keni pranuar edhe planin e komitetit për komunitete që mendoj që është përgatitur mirë dhe është brenda kompetencave të tyre. Komitete konsultative të cilat janë formuar janë që i hynë në punë komunës, ndërsa me formuar komitete të tjera duhet të marrim mendim prej ekzekutivit dhe prej organeve profesionale se a kemi nevojë apo nuk kemi nevojë.

Mefail Suma thekson:-unë pajtohem me atë që potencon që kanë drejtë por nuk po e potencon atë që nuk kanë të drejtë se po të merret shembull komiteti konsultativ për ekonomi dhe bujqësi asnjë pikë që është paraparë nuk parasheh zhvillimin e bujqësisë apo diçka për zhvillim ekonomik sepse këto pika i parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Kryesuesi thekson:- rregullisht kemi kërkuar nga komiteti konsultative që planin e punës me hartuar në kuadër të kompetencave që ju takojnë, mirëpo këto janë pika vetëm bazë sepse kanë mundësi në të ardhmen me u shtuar.

Mefail Suma thekson:- për këtë çështje ose administrata i ka fajet apo udhëheqësit e komiteteve konsultative nuk lexojnë për shkak se duhet ta marrin ligjin dhe rregulloret në mënyrë që ti lexojnë se çfarë kompetenca kanë. Duhet ta lexojnë nenin 73 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale se aty tregon se këto komitet i ka formuar kuvendi i komunës. është viti i katër dhe asnjë herë nuk është dërguar ndonjë propozim nga komitet konsultative për me shqyrtuar dhe me miratuar kuvendi i komunës.

Mehmet Ballazhi thekson:- pika e cila u propozua nga parafolësi është mirë që të ipet një arsyetim në mënyrë që pastaj e diskutojmë dhe e qesim në votim për me diskutuar si pikë të rendit të punës. Në KPF kemi dhënë vërejtjet dhe e keni pasur procesverbalin e KPF-së, mirëpo si pikë e rendit të ditës nuk do të ishte keq nëse hynë sepse kemi të drejtë me propozuar ndonjë pikë si anëtarë të kuvendit nëse është e nevojshme. Sa i përket ekzekutivit për këtë çështje ka të drejtë me dhënë mendimin e vetë por kuvendi i komunës ka drejtë mi themeluar komitetet konsultative tjera shtesë. Për komitet konsultative ne i kemi dhënë vazhdimisht vërejtjet tona edhe në KPF por edhe në kuvendin e komunës. Vërejtjet tona janë zbatuar me një far forme, janë marr parasysh dhe ndoshta disa nuk zbatohen por shihet që ka një evoluim më pozitiv duke bërë ndryshime te plani i punës së komitetit për komunitete dhe te komitete e tjera.

Mefail Suma thekson:- afër tetë vite kam qenë asamblistë dhe brenda mandatit të juaj pika më e dobët e ekzekutivit të komunës është menaxhimi i pronës komunale prej vitit 2009 por edhe më parë. Unë kam kërkuar se a është bërë regjistri i pasurisë së patundshme të komunës dhe këtë pyetje e kam parashtruar për shkak se nëse më pyesin qytetarët me ju treguar se komuna e Hani të Elezit i ka këto prona. Teknologjia ka avancuar dhe kanë mundësi me na treguar me ngjyra se sa sipërfaqe ka komuna. Më kujtohet kur z.Emrush Suma e patë marr me ndërtuar një banesë dhe në momentin që është shfuqizuar vendimi kryetari i komunës potencoj që gjashtëdhjetë ari tokë janë pas ndërtesës së objektit të mirëqenies sociale dhe kërkoj ta dijë se a është uzurpuar ajo pronë dhe nëse është uzurpuar a është identifikuar personi. Për atë propozova që të formohet një komitet konsultativ për pronën komunale.

Kryesuesi thekson:- auditori ka dhënë vërejtje për çështje të regjistrimit të pronës komunale dhe ekzekutivi i komunës edhe në këtë vit është duke punuar për këtë çështje . Unë mendoj që një takim i përbashkët ndërmjet ekzekutivit të komunës dhe kuvendit të komunës do të kish kontribuar shumë sepse po që se formohet edhe një komitet është barrë e komunës për shkak se me çështje tjera nuk merret dhe pasi që ekzekutivi i komunës është duke punuar për këtë çështje nuk e shohë të arsyeshme formimin edhe të një komiteti konsultativ.

Mefail Suma thekson:- unë mendoj që formimi i këtij komiteti do ta kish ndihmuar drejtorinë përkatëse për shkak se asnjë komitet nuk e shqyrton planin e drejtorisë. Komiteti konsultativ për çështje të pronës do të i cakton uzurpatorët sepse ne e dimë që komuna ka pak problem për me i regjistruar por me ndihmën e organeve të sigurimit me i shikuar këto punë për shkak se ne jemi rritur në Han të Elezit dhe po shohim që po ndërtohen shtëpitë. Ju thoni se krejt mirë është por unë mendoj që komuna nuk ka kurrfarë të mire rreth menaxhimit të pronës së patundshme të komunës.

Mehmet Ballazhi thekson:- ne po e diskutojmë si pikë ndërsa në fakt se kemi pikë të rendit të punës dhe ose ne të hynë në rend të punës apo nuk po e diskutojmë.

Kryesuesi thekson:- unë jam që drejtori të jetë prezentë dhe është mirë që me u konsultuar me drejtorin për urbanizëm dhe në mbledhje të ardhshme mund të hyjë në rend të punës për shkak se duhet të bisedojmë me drejtorinë për urbanizëm se deri ku kanë mbërri punët për këtë çështje. A ka diskutime tjetër për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për , 1 kundër (z.Mefail Suma- grupi parlamentarë Nisma).

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojm me këtë rendë të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Propozim vendim për ndarjen e bursave për studentë.
4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2021.
5. Plani i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021.
6. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2020.
7. Shfuqizimi i vendimit me numër 01/Nr.9228/2020 për ndërrim destinim të pronës.
8. Rregullorja për taksa komunale për vitin 2021.
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- në muajin shkurt do ta keni një informatë me shkrim për koronavirusin me të gjitha specifikat. Janë duke u bërë dy lloj testesh , testi serologjik që bëhet nga QKMF-ja dhe testi që bëhet nga instituti kombëtarë i shëndetit publik. Gjatë këtij muaji sipas institutit kombëtarë të shëndetit publik kemi pasur tre raste. Sa i përket testeve serologjike vetëm gjatë këtij muaji janë bërë 350 teste serologjike që shumica prej tyre dalin që e kanë kaluar, ndërsa një pjesë janë pozitiv. Në ambulantë deri në gjashtëdhjetë teste brenda ditës janë bërë dhe interesim të madh nuk ka për shkak se shihet që ka rënë niveli i koronavirusit në Han të Elezit për dallim prej herëve të tjera që zyrtarisht i konfirmoheshin rastet që ishin një , dy apo tre ndërsa gjendja në praktik në QKMF ishte krejt ndryshe se ishin njëqind raste apo ndoshta edhe më tepër. Në bazë testeve serologjike 65 % e qytetarëve e kanë kaluar koronavirusi dhe do të ishte mirë që edhe ju si anëtarë të kuvendit të komunës ta sensibilizoni te qytetarët çështjen e testeve që me ardhur dhe me i kryer për shkak se po hezitojnë e po mendojnë që bëhen vetëm për institucionet.

Mehmet Ballazhi thekson:- nëse vijnë vaksinat për koronavirusin a ka ndonjë informacion se si do të bëhet shpërndarja e tyre dhe a ka ndonjë kriter se si do të shpërndahen në komuna të caktuara.

Rufki Suma thekson:- nuk kemi ndonjë rekomandim për shkak se nuk kanë ardhur por po besojmë që në momentin kur të vijnë do të i thërrasin drejtorët e drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Për momentin nuk ka ndonjë plan për shpërndarjen e vaksinës.

Sabedin Hasallari thekson:- testet aerologjike që po bëhen në QKMF , personat të cilët dalin pozitiv çka ju rekomandohet nga QKMF-ja .

Rufki Suma thekson:-prej instituti kur i kemi pasur sipas udhëzimit administrativ i është lëshuar vendim dhe është izoluar e tërë familja. Për personat të cilët e bëjnë testin serologjik dhe dalin pozitiv QKMF-ja i rekomandon që me nejtë në vetizolim dhe e njoftojnë drejtorinë komunale pastaj njoftohet edhe drejtoria e arsimit në mënyrë që ajo familje nëse ka fëmijë në shkollë ju rekomandon që me u vetizohet.

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Propozim vendim për ndarjen e bursave për studentë.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- në miratimin e buxhetit të komunës për vitin 2021 i kemi ndarë 15000 € për bursa për studentë . Kemi potencuar që duhet të ndahen 30 bursa dhe i kemi caktuar fakultete prioritare. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni

Mehmet Ballazhi thekson:- drejtimet të cilat janë propozuar në këtë propozim vendim , a ka studentë që nuk është paraqitur në këto drejtime. A duhet të ndryshohen këto vendime apo duhet t'i sensibilizojmë studentët për me aplikuar për shkak se po na mbesin si teorike.

Hanumshahe Dibrani thekson:- rekomandojë që vitin e fundit studentët të cilët kanë qenë përfitues të bursës tre deri në katër vite të pajisen me ndonjë dokument nga DKA-ja dhe në momentin që do të konkurrojnë për punë të merret parasysh ky dokument gjatë konkursit

Sabedin Hasallari thekson:- studentët të cilët ishin përfitues të bursës nga viti i dytë e tutje a i kanë kryer studimet me sukses.

Samire Curri thekson:- propozoj që si drejtim deficitarë të fakulteti i bujqësisë dhe veterinarisë të jetë edhe fakulteti i bioteknologjisë ushqimore.

Sead Vila thekson:- e kam hasur diku që bëhen vizita te maturanët në mënyrë që të orientohen nëpër drejtime studimore që janë deficitare, a është vetëm si plan apo vërtetë ka praktika të tilla. Sa ka bërë punë konkrete drejtoria e arsimit në këtë drejtim dhe është mirë me u organizuar takime me maturanët për me i orientuar në orientim në karrierë dhe në drejtimet të cilat janë deficitare.

Menduh Vlasi thekson:- edhe në KPF kam potencuar që kemi disa drejtime që nuk kanë aplikuar studentët , mirëpo ne i mbajmë këto drejtime sepse një formë e sensibilizimit është edhe kjo. Për çdo vit e publikojmë konkursin dhe potencojmë që prioritet do të kenë këto fakultete. Vitin e kaluar ka qenë e planifikuar me mbajtur takim me maturanët së bashku me kryetarin e komunës por për shkak të kovidit nuk kemi mundur me organizuar një gjë të tillë. Në fund të këtij viti planifikojmë me organizuar në takim të tillë por varet si do të zhvillohen rrethanat me pandeminë. Në shkollë të mesme është kabineti për orientim në karrierë dhe personeli i arsimit vazhdimisht duhet të punon me maturanët për me i orientuar në drejtime deficitare. Nëse studentët parashtrajnë kërkesë ne mund të ju lëshojmë dokumentet se kanë qenë përfitues të bursës , ndërsa sa i përket punësimit është Ligji dhe Udhëzimet Administrative që i përcaktojnë kriteret . Shënime nuk kam se sa studentë kanë marr bursë dhe e kanë kryer, por kam bindje që pjesa dërmuese që kanë marr bursë i kanë kryer studimet.

Teuta Shkreta thekson:- a keni bërë ndonjë statistikë në bazë të regjistrimit të studentëve për shkak se ndoshta ka ndonjë studentë që drejtimi i tij nuk është në këtë listë dhe ndoshta ne kishim mundur me ndryshuar.

Menduh Vlashi thekson:- drejtimet deficitare që janë paraparë nuk dallojnë shumë përpos që pesë pikë i shtohen si drejtim deficitarë .

Mehmet Ballazhi thekson:-unë besoj që bioteknologjia ushqimore hynë në kuadër të fakultetit të bujqësisë. Sensibilizimi më i mirë do të ishte bërë përmes shkollave që drejtorja e arsimit përmes drejtorëve të shkollave me ju dhënë rekomandim që me i para orientuar nxënësit. Unë propozoj që në kuadër të fakultetit Filologjikë të jetë edhe gjuha angleze dhe gjuha gjermane si drejtime deficitare.

Florim Shkreta thekson:- a ka pasur studentë të cilët janë subvencionuar prej komunës në bazë të disa marrëveshjeve me disa kolegje që i kanë bërë më herët dhe nëse mundemi me ditur se kush janë ata studentë.

Menduh Vlashi thekson:- bursat ndahen në kuadër të kësaj shumë dhe pasi të ndahen ju sjelli raport në kuvendin e komunës dhe jashtë kësaj shumë unë nuk ndajë bursa por subvencionimet bëhen në formë tjetër.

Rufki Suma thekson:- ka qenë marrëveshja me UNIVERSUM-in i cili i ka dhënë 3 bursa por edhe një vend ka mbetur i lirë për shkak se nuk ka pasur të interesuar.

Akif Shkreta thekson:- a ke ndonjë listë për studentët të cilët nuk kanë qenë përfitues apo kanë përfutuar të gjithë studentët të cilët kanë aplikuar

Menduh Vlashi thekson:- vitin e kaluar kanë mbetur pa përfutuar bursë tre apo katër studentë të vitit të parë. Sipas informatave që kam pjesa dërmuese e këtyre që kanë marr bursa e kanë kryer mastarin e disa prej tyre i kanë ndjekur studimet edhe në doktoraturë. Është mirë në të ardhmen komuna me ndarë bursa edhe për studentët që i vazhdojnë studimet në master.

Kryesuesi thekson:- studentët të cilët janë përzgjedhur për me i kryer studimet në UNIVERSUM janë z.Urim Qaili dhe Fatbardh Braka. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim rregulloren; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË

4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- planin e punës të cilin e kanë hartuar për vitin 2021 është për tu përshëndetur sepse është hartuar në kuadër të kompetencave të veta të cilat i kanë si komitet. Për vitin 2021 i kanë planifikuar dhjetë mbledhje. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sead Vila thekson:- në plan është paraparë monitorimi i qendrës për të rinjë por kërkoj të dijë se ku është kjo qendër. Është planifikuar zyrës për kthim, kjo zyre a funksionon në kuadër të ndonjë drejtorie apo është zyre e veçantë.

Teuta Shkreta thekson:-plani i punës për vitin 2021 është hartuar shumë mirë dhe në kuadër të këtij plani është paraparë një takim me këshillat e fshatrave, mirëpo unë propozoj që edhe ne si anëtarë të kuvendit të komunës me i takuar këto këshilla të fshatrave.

Mehmet Ballazhi thekson:- do të ishte mirë që brenda këtij komiteti me propozuar dhe me hyjë në plan diskutimi rreth çështjes së pronave.

Isni Bushi thekson:- në plan të punës ishte paraparë me diskutuar hulumtimi për qytetarët e komunës të cilët nuk e kanë përfunduar shkollën e mesme, në veçanti femrat por më mirë është dashur të hulumtohet për ata të cilët nuk e kanë kryer shkollën fillore , kur dihet se shkolla e mesme nuk është obligative. Duhet të caktohet mosha për ata të cilët nuk e kanë kryer shkollën fillore e pastaj të vazhdohet me shkollën e mesme.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë mendoj që kjo do të hynë te komiteti konsultativ për arsim.

Rufki Suma thekson:- monitorimi i qendrës rinore me siguri fjala është për qendrën rinore, ndërsa sa i përket komunitetit për kthim, është zyra për komunitet dhe kthim në komunë. Ky është plan dhe mund të plotësohet për hulumtimin e atyre të cilët nuk e kanë kryer shkollën fillore dhe të mesme

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për 1 abstenim (z.Mefail Suma- grupi parlamentarë Nisma).

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2021

5. Plani i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- të gjitha komiteteve konsultative ju kam dërguar ftesë që të jenë pjesëmarrës në mbledhje të kuvendit të komunës. Prezent në mbledhje të kuvendit është kryesuesja e komitetit konsultativ për arsim , kulturë, shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Besiane Thaçi thekson:- ne kemi hartuar planin dhe e kemi dërguar në kuvend për miratim. Pasi jam pjesë e shëndetësisë kemi propozuar disa pika që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe që janë më të rëndësishme.

Mehmet Ballazhi thekson:- në muajin nëntor është paraparë Dezinfektimi, deratizimi dhe asgjësimi i QKMF-së është mirë të modifikohet kjo pikë e rendit të punës.

Besiane Thaçi thekson:- është një gabim teknik por duhet të jetë Dezinfektimi, deratizimi i objektit të QKMF-së sepse me udhëzim administrativ parashihet kjo çështje.

Sead Vila thekson:- një aktivitet që është harruar dhe nuk po praktikohet tek ne janë kuizet e nxënësve. Është anashkaluar edhe organizimi i garave sportive në komunën tonë dhe nëse gjinia femërore inkuadrohet në komunën tonë në voliboll apo edhe me ndonjë sport tjetër me u përfshirë do të ndikonte tek të rinjtë që me u larguar nga dukuritë negative apo një pjesë e tyre që rrinë në kafiteri të ndryshme. Urojë që të ketë sukses ky plan dhe të zbatohet.

Isni Bushi thekson:- te komiteti për arsim, kulturë, shëndetësi dhe mirëqenie sociale shpërndarja e mbledhjeve është bërë ndërsa komitete tjera i kanë përcaktuar mbledhjet për çdo muaj.

Kryesuesi thekson:- komitetet planifikimet i kanë bërë në këtë formë për shkak se në këtë vit janë edhe zgjedhjet lokale.

Teuta Shkreta thekson:- komiteti për shërbime publike ka planifikuar në muajin qershor si pikë të rendit të ditës, vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2021. Në KPF e kam dhënë këtë vërejtje.

Kryesuesi thekson:- kjo është ndryshuar dhe është përcaktuar si diskutim për normat tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2021.

Mefail Suma thekson:- komiteti konsultativ për arsim, kulturë, rini dhe sport sa ka bashkëpunim me shkollat e komunës së Hanit të Elezit. Çka është paraparë nga ky komitet konsultativ për fëmijët para shkollorë nëpër fshatra. Ky komitet pasi ka të bëjë edhe me shëndetësi sa ka bashkëpunuar me komunë për çështjen e kovidit që është paraqitur dhe ka kërkuar edhe prej komunës. Te Komiteti për zhvillim ekonomik nuk kam pa ndonjë pikë të rendit të punës rreth zhvillimit ekonomik, nuk ka paraparë ndonjë propozim rreth të mbjellurave në mënyrë që me i identifikuar vendet se cilin me i mbjell me grurë, cilin me mbjell me thekër . Çfarë bashkëpunimi ka ky komitet me fshatrat në mënyrë që me identifikuar se ku është e meta që nuk zhvillohet bujqësia në kuptimin e të mbjellurave dhe në drejtime të tjera. Pastaj në çështje të urbanizmit me diskutuar se ka evidentuar dikund që është ndërtuar apo a kanë ndonjë plan se ku me ndërtuar ndonjë lagje të re. Me i identifikuar ndërtimet që janë bërë pa leje ndërtimi. Këto komitete nuk po e dinë qëllimin e formimit të këtij komiteti. Këto komitete nuk i japin raport ekzekutivit për shkak se kuvendi i komunës i ka themeluar dhe mungon bashkëpunimi i kuvendit të komunës me këto komitete sepse nuk e kanë luajtur rolin dhe funksionin e atij komiteti që e kanë për shkak se asgjë me shkrim nuk na kanë sjell në kuvend.

Besiane Thaçi thekson:- si komitet kemi dalë nëpër shkolla dhe e kemi parë për së afërmi gjendjen e shkollave dhe pajisjet mbrojtëse që janë për çështjen e kovidit.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për 1 abstenim (z.Mefail Suma- grupi parlamentarë Nisma).

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KATËR KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2021

6. Informatë mbi veprimtaritë e subjekteve afariste për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- diçka të veçantë nuk kam përpos materialit të cilin e ka përcjellë drejtoresha.

Sead Vila thekson:- edhe pse viti 2020 ka qenë vit i vështirë për shkak të pandemisë por shifrat po flasin diçka pozitive për shkak se 46 biznese të reja janë hapur dhe vetëm tri biznese janë mbyllur. Është bërë kategorizimi i subjekteve biznesore e afariste dhe janë shënuar 24 hoteleri dhe kërkoj informacion se cilat biznese janë në këtë kategori.

Mehmet Ballazhi thekson:- më shumë po më duken shifra sepse nuk është që 352 kanë qenë aktive dhe 46 biznese të reja të lenë me u intuzjasmuar në kohë pandemi por më poshtë kur të shikohen shifrat e inkasimit të lenë me kuptuar se janë formale por duhet të japim rezultate e mos të bëjmë vetëm shifra.

Sabedin Hasallari thekson:- në komunën tonë 352 subjekte afariste zhvillojnë biznesin në komunën tonë, kërkoj që të na sqarohet me një tabelë tjetër për shkak se disa biznese janë fiktive për shkak se ka biznes që prej viti 2000 është i regjistruar dhe nuk paguan tatim për zhvillimin e veprimtarisë në komunën tonë dhe duhet të dihen se cilat janë ata biznese për shkak se vetëm ekzistojnë në letër e nuk zhvillojnë veprimtari. A ka ndonjë biznes që e ka zhvilluar veprimtarinë që katër vite dhe tash ka filluar me paguar taksën për ushtrim të veprimtarisë për shkak se shumica e bizneseve po regjistrohen të reja dhe nuk po e vazhdojnë veprimtarinë. Bizneset të cilat nuk e ushtrojnë veprimtarinë të shënohen me një kolonë të veçantë në mënyrë që të dihen si biznese që nuk e ushtrojnë veprimtarinë. A ka biznese të cilat e zhvillojnë veprimtarinë në mënyrë ilegale.

Rufki Suma thekson:- është mirë që me u ndarë bizneset por kemi biznes që ndoshta është shuar si biznes por nuk është ç'lajmëruar te ATK-ja dhe komuna e liron prej taksës komunale por si biznes jetë për shkak se nuk i ka kryer obligimet ndaj ATK-së. Të gjitha bizneset e reja të cilat janë me pronarë meshkuj nuk paguajnë për dy vite taksë komunale, ndërsa bizneset e reja që janë me pronarë femër nuk paguajnë katër vite taksë komunale.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Shfuqizimi i vendimit me numër 01/Nr.9228/2020 për ndërrim destinim të pronës.

Kryesuesi thekson:- vendimi është miratuar në mbledhje të kaluar dhe e kemi përcjell për shqyrtim të ligjshmërisë në Ministri të Pushtetit Lokal dhe ministria ka kërkuar që vendimi të shfuqizohet. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Bajrush Laçi thekson:- vendimi është për ndërrim destinim të pronës bujqësore që është miratuar në mbledhjen e kaluar të kuvendit të komunës. Drejtoria ka menduar që kjo pronë është paraparë në planifikim hapësinorë dhe nga kuvendi i komunës është marr ky vendim dhe pasi është dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë në Mistri të Pushtetit Lokal është vërtetuar se është afër vijës së planit hapësinorë por nuk përfshihet në planifikim hapësinorë, andaj si i tillë nuk prodhon efekt juridik dhe duhet të shfuqizohet.

Mehmet Ballazhi thekson:- si kuvend kemi votuar për të gjithë për shkak se nuk jemi për me penguar askënd është mirë herëve të tjera ekzekutivi ti shikon më me kujdese çështjet se a preket ligji në mënyrë që mos me dal në lajthitje si kuvend i komunës për shkak se duam me i bërë mirë dikujt dhe dalim në pozitë të keqe.

Kryesuesi thekson:- ekzekutivi llogaritet organ profesional nëse e sjellin një material e miratohet e bëhet shkelje faji është i tyre për shkak se këta i kanë organet profesionale. Urbanizmi i ka udhëheqësit e vetë dhe nëse e sjellin jashtë planit ata na kanë shtijë për me shkelë për shkak se nëse kemi ndonjë anëtarë të kuvendit të komunës që është i lamisë së urbanizmit mund të jep kontribut. Lëndët që na i sjellin ne i votojmë për shkak se mendojmë që janë në rregull dhe është mirë që ekzekutivi i komunës me pasur kujdes e jo kuvendi.

Rufki Suma thekson:- probleme si ekzekutiv jemi duke pasur për shkak se kemi rastin e rregullores për taksa komunale në të cilën na kanë rekomanduar Ministria me rishqyrtuar e me i bërë ndryshimet dhe në kuvend janë bërë ndryshimet, ndërsa përsëri kanë kërkuar që me bërë rishqyrtim Ministria. Deri më tani kemi vepruar në këtë formë dhe e kemi dituar se në Han të Elezit nuk kemi plane urbane urban nëpër fshatra përveç zonës urbane që e kemi dhe të gjithë ata të cilët kanë ndërtuar në pronat bujqësore ua kemi bërë ndërrim destinimin dhe nuk kemi pasur probleme për këtë çështje. Afër kësaj parcele ka shtëpia të ndërtuar ndërsa tash rekomandojnë për me shfuqizuar vendimin.

Bajrush Laçi thekson:- nuk është puna lajthitje sepse Ministria edhe për vendimin e më hershëm të cilin e kemi marr për ndërrim destinim e ka dërguar si anti ligjorë dhe fillimisht e kanë shënuar emrin e komunës sonë në gjuhën serbe dhe kanë potencuar se është anti ligjorë, ne kemi reaguar me shkrim dhe e kemi dërguar që është brenda planit hapësinorë, kemi kërkuar që emri të ndryshohet. Ministria i ka bërë ndryshimet dhe e kanë dërguar që vendimi është ligjorë. Drejtoria për vendimin që ka kërkuar me u bërë ndërrim destinimi parcela ka qenë mu në vijë të planit hapësinorë dhe në vendim është shënuar ashtu siç është. Ministria ka potencuar që nuk mund të ndryshohet kultura pa e zgjeruar planin hapësinorë.

Mehmet Ballazhi thekson:- rekomandimi jonë si anëtarë të kuvendit të komunës është që mos të dalim ne si kuvend i komunës keq dhe është mirë kur të përcillet një lëndë për miratim në kuvend të jetë në mënyrë profesionale.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA SHQUQIZIMI I VENDIMIT ME NUMËR 01/Nr.9228/2020 PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

8. Rregullorja për takasa komunale për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Bajrush Laçi thekson:- ministria ka kërkuar që të bëhen katër përmirësime njëri ka të bëjë me drejtorinë e arsimit që ka të bëjë me udhëzimin administrativ 11/2001 që të hiqet e të shtohet 01/2017, mirëpo unë kur e kam parë këtë udhëzim nuk përkon me atë që e kemi shënuar dhe ky udhëzim është për botimin e publikimeve shkencore të revistave për faktorë ndikimi. Duhet ta diskutojmë me Ministrinë e Arsimit çështjen e këtij udhëzimi për shkak se deri tash nuk na u kanë bashkangjitur. Pjesa tjetër është që të riformulohet. Ndryshimi tjetër që duhet të bëhet është te udhëzimi administrativ i urbanizmit neni 11 paragrafi 1 kanë rekomanduar që të vendoset udhëzimi 13/2019. Te drejtoria e shëndetësisë në vend të udhëzimit 2011 të shtohet 04/2013 për certifikatat shëndetësore. Këtë rregullore e kemi pasur në rend të punës për rishqyrtim dhe është bërë rishqyrtimi ashtu siç ka kërkuar ministria dhe vërejtjet të cilat i kanë dhënë të cilat ishin shumë kozmetike i kemi ndryshuar. I kemi dërguar në ministri dhe nuk kanë shkuar te i njëjti zyrtarë por te tjetri dhe ka rekomanduar me ndryshuar diçka tjetër dhe me një far forme kanë bërë presion se nëse nuk e rishqyrtoni në kuvend do ta përcjellim në Ministri të Drejtësisë që përmes asaj me dërguar në gjykatë dhe për këtë arsye e kemi përcjell për rishqyrtim. Ne ua kemi dërguar shkresën që do të i zbatojmë të gjitha udhëzimet administrative të cilat kanë kërkuar me i rishqyrtuar.

Mehmet Ballazhi thekson:-nëse i miratojmë rekomandimet e dhënë ndoshta do të shkon te ndonjë zyrtarë tjetër i cili mund të kërkon përsëri me ndryshuar ndonjë nen apo ndonjë paragraf të rregullores. Unë kisha propozuar që këtë rregullore me kaluar pa i dhënë ndonjë miratim final nëse ekziston mundësia me definuar në këtë formë për shkak se mund të kthehet në rishqyrtim përsëri.

Kryesuesi thekson:- rishqyrtimi kur të hynë në rend të punës ne duhet ti plotësojmë vetëm rekomandimet nga Ministria. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 12 për, 2 abstenim (nga grupi parlamentar i PDK-së z.Mehmet Ballazhi dhe znj.Besarta Suma).

U MIRATUA RREGULLORJA PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2021

3. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sead Vila thekson:- kam parashtruar një pyetje rreth përfaqësimit në komitetet obligative por aspak nuk jam i kënaqur me përgjigjen që më është dhënë por mu personalisht por ndoshta edhe për një numër të konsiderueshëm nëse dërgohet nuk e pranojnë si interpretim por mund të jetë një përshkrim i neneve dhe i rregullores për shkak se pjesën e parë vetëm e ka përshkruar siç është në rregullore , ndërsa te pjesa e fundit e ka devijuar dhe ka ardhur në atë masë se unë jam një individë por nuk jemi individ por jemi subjekte politike që e përfaqësojmë kuvendin e komunës. Disa janë përfaqësues nëpërmes partive politike e disa mund të jenë nëpërmes listave, e disa të pavarur që është e drejtë ligjore për secilin. Përgjigjja nuk ka qenë adekuat apo ndoshta ka qenë me ndonjë tendencë për me larguar, mirëpo për mu e quaj kapitull të mbyllur se nuk kam interes as unë as z.Mefali Suma që të jemi në përfaqësim në komitet.

Kryesuesi thekson:- në ligj shënon përfaqësimi i etnive që e përbëjnë kuvendin e komunës dhe mendojmë që katër parti mendojmë që duhet të kenë përfaqësues. Nuk kemi pasur mundësi me përfshirë më shumë dhe interpretimi është në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Sead Vila thekson:- në rregullore e kam hasur që duhet të jetë përfaqësimi politik dhe gjinorë por aty nuk ceket as numri as logoja e partisë për shkak se me potencuar që unë jam individ është fyese sepse përveç që jam qenie biologjike dhe jam edhe qenie sociale për shkak se është tepër e ulët me i thënë dikujt që je individë që lëvizë prej një vendi në një vend caktuar, mirëpo është e drejtë ligjore që parimet e mia nuk mundet me mi ndryshuar dhe me gjithë respektin që kam përgjigjen që e kam pranuar nuk mu dukë profesionale.

Kryesuesi thekson:-në përgjigje ka mundur me u potencuar por nëse ligji e precizon një gjë të tillë duhet të vlejë ligji.

Bajrush Laçi thekson:- unë nuk kam bërë interpretim të pyetjes por e kam dhënë një përgjigje të cilën e përcakton ligji, interpretimin e rregullores ose të ligjit e bënë organi që e nxjerrë , interpretimin e rregullores së kuvendit e bënë kuvendi i komunës por unë me dhënë një komentim për atë çështje e jo me interpretuar për shkak se interpretimi është fushë më e gjerë. Nëse përgjigjja nuk të pëlqen mundesh me kërkuar interpretim në Ministri të Pushtetit Lokal se a përfaqëson ndonjë entitet politik apo ndonjë subjekt politik apo individ.

Florim Shkreta thekson:- kërkoj sqarim nga drejtoria e arsimit se pse është anuluar konkursi te çerdhja. Përgjigjen që e kam marr në mënyrë elektronik unë më shumë e konsiderojë kur dikush ta dërgon një letër dashurie. Pyetjen ja kam parashtruar kryetarit të komunës për vizitën e afaristit. Nuk mund të jetë ndonjë problem apo faj i kryetarit të komunës që është takuar për shkak se kush do mund të vjen në vizitë , mirëpo mënyra se si keni vepruar ka bërë që me dyshuar sepse takimi nuk bëhet publik në kohën e duhur dhe është publikuar pas katërmëdhjetë dite. Kur është publikuar potencohet që ka dhënë donacion disa lloptop , a nuk është marre nëse dikush të jep diçka më së paku që duhet të thuash është që ta falënderosh dhe ta publikosh.

Kryesuesi thekson:-në portale keni lexuar pak më vonë tash se personin për të cilën bëhet fjalë ka qëndruar në Maqedoni tre muaj dhe është dëbuar prej Maqedonisë, është në Kosovë sepse ka shtetësi Kosovare . Siç kanë potencuar organet e Maqedonisë për këtë person atëherë organet tona të shtetit duhet të ndërmarrin diçka në bazë të ligjit për këtë çështje.

Florim Shkreta thekson:- çdo person mund të merret me dukuri të ndryshme por neve na kanë interesuar puna jonë që neve na takon dhe përgjigjen që e kem marr nuk ka qenë për atë që kemi kërkuar dhe vet tërheqja taktike që është bërë në përgjigje tregon mënyrën se këtu ka diçka më shumë.

Mehmet Ballazhi thekson:- përgjigjja më është dhënë për çështjet e tatimit në pronë të shtëpia e vetmuarve se do të merret një vendim që me heqë prej tatimit në pronë për veç qirasë. Si do të kryhet kjo procedurë. Sa i përket përgjigjes që kam marr për vizitën e Sedat Peker në komunën tonë dhe po që se hynë në internet në wikipedia që është shumë zyrtare në të cilin hyjnë të dhënat e pash që ishte një lloj kriminel se ashtu shkruante në wikipedia. Në bazë të këtyre informacioneve një kriminel me ardhur në komunën e Hanit të Elezit e kryetari i komunës mos me pasur njohuri nuk është brenda logjikës për shkak se nesër po mujka me ardhur çfarëdo personi e kryetari i komunës mos me ditur. Në përgjigje është potencuar se i ka sjell disa lllaptopë, ndërsa në rrugë policia na pa, mendoj që është hajgare po komedi komike dhe unë mendoj që kjo nuk është për mashtrim por duhet me qenë shumë seriozë se çka po ndodhë tu e shfajësuar edhe kryetarin në këtë rast se kryetari i komunës është ai që po i mbanë gjitha përgjegjësitë dhe mund të ja ketë bërë dikush ndonjë far grope që na nuk e dimë por e ka sjellë dhe i ka potencuar që është një biznesmenë dhe ndoshta edhe unë e kisha hangar këtë formë por jo përgjigjja të jetë kësi soi. Përgjigjja që është dhënë për përcjelljen me polici që unë mendoj që polica nuk rrinë të ura mi prit kur shkojnë dhjetë kerre mos ka ndodhë ndonjë problemë e ku janë dy kerre nuk ka problem , mirëpo ka një koordinim të jashtëzakonshëm për me përcjell me drita që me bërë bajagi të madhe këtë punës se erdhe dikush. Kryetari duhet ta jep një përgjegjësi shumë të saktë , shumë të pranueshme dhe e qartë me kanë se çka është puna sepse ndoshta hyjnë këtu kriminele dhe persona që merren me dukuri negative e na s'pe dimë çka sillet për rreth nesh e mos me i marr në mënyrë formale e me u kënaqur me një përgjigje të komedive të shkurtra.

Kryesuesi thekson:-para një jave është arrestuar në Maqedoni dhe është dërguar në Kosovë dhe është mirë të arrestohet për shkak se kishte nënshtetësi Kosovare. Prokuroria në bazë të portaleve mund të ngritë aktakuzë dhe përgjegjësin nuk e mbajmë na por e mbajnë ata të cilët nuk e ngritin aktakuzën.

Florim Shkreta thekson:- si kryesues sqarim je tu dhënë por ponë me bërë më të madhe këtë punë, neve na intereson vetëm kjo pjesa sepse ju nuk jeni të drejtë me qytetarin dhe nuk jeni transparentë e nuk e ipni siç duhet atë që ta kërkon dikush.

Mehmet Ballazhi thekson:- kur bisedohet për këtë çështje nuk di pse po i jepni zor shumë por duhet të jetë shqetësimi jonë dhe i gjithëve për shkak se hynë një kriminel pa e ditur kryetari i komunës por jo me vepruar me të me shkuar poshtë e përpjetë e me polici dhe këto gjëra duan sqarime.

Rufki Suma thekson:- në zyre të kryetarit të komunës brenda ditës vijën njëzet deri në tridhjetë persona e prej tyre vinë biznesmenë, hajna , vijnë edhe të mirë edhe të kshi, vijnë hoxhallarë dhe të tjerë që do të thotë kush të vere i pranojë kur i dijë dhe kur nuk i di ju them që nuk kam mundësi. Kur është në pyetje te biznesmenët apo persona të huaj gjithmonë i bien dikush se unë nuk mundem me i njohur drejtë për së drejti. Lidhje pas lidhje vijnë afaristë të ndryshëm dhe për të njëjtin person kanë potencuar se do të vjen një afaristë turk dhe kam potencuar që ne të vjen dhe nuk ja kam ditur as emrin se për këndë bëhet fjalë dhe ka ardhur dhe ka nejtë. Për mu befasuese ka qenë se me sa persona ka ardhur dhe në bazë të asaj e kam parë që ai person ka bashkëpunim , bashkëpunon me persona në Kosovë, me politikanë , e qeveritarë, ka ndjetë në Kosovë me javë me mujo e me vite, ka bërë biznese në Kosovë dhe Maqedoni. Ne i publikojmë të gjitha kur kemi informata ndërsa kur nuk kemi informata të plota presim deri sa ti marrim informacionet. Kur e ka ardhur informata dhe kemi ditur që kush është e për shkak të fyerjeve të panevojshme që filluan me bërë është hequr nga vebfaqja e komunës informatën. Në përgjigjen e dhënë e kam treguar një të vërtetë se si ka qenë që kush do që ka ardhur

kemi dal në vizitë te varrezat e dëshmorëve në Pustenik qoftë në drekë apo në darkë dhe jemi ardhur. Kur patrulla ka pyetur se çka ka se ka shumë automjete në Pustenik kam potencuar se është një delegacion Turk dhe kanë qëlluar te Ura e Seçishtë dhe kanë ardhur me përcjellje deri këtu. Ka filluar ndërkohë politika përmes PDK-së që kryetari i komunës ka pranuar terroristë dhe pastaj më kanë thirrë mediat të cilave ju kam përgjigjur. Mediat potencuan që ke pranuar kriminel ju kam jo dhe pastaj potencuan me emër dhe u thashë që por nuk ja kemi ditur historinë dhe mediat potencuan që është kriminel dhe ua kamë than se po të jetë kriminel ai duhet të jetë në burg por ka ardhur përmes pikës kufitare e sikur të jetë i dënuar policia do ta arrestonte e nuk e shoqëron . Medieve ju kam potencuar se historia tregon që Vuçiqi është kriminel që ka vrarë shqiptarë por qeveritarët e Kosovës po merren në grykë dhe po takohen për ditë dhe kryeministri dhe presidenti përqafohet me një kriminel që është i ditur botërisht që ka bërë krime në Kosovë e Rufki Suma e paska pranuar një biznesmen që as nuk ja ka ditur historinë. PDK-ja në Han të Elezit është mundur me potencuar se u arrestua bashkëpunëtori i ngushtë i Rufki Sumës por ata janë çështje të tjera që nuk po i mohojë se politika këqyr me të nxanur me ndonjë gabim që është normale por në përgjigje i kam dhënë arsyetimet e mia qysh na e kemi ditur . Me pas ditur se kush është me kohë ju kisha thënë që nuk kam kohë por nuk e kemi ditur.

Mehmet Ballazhi thekson:- po më vjen keq nga ajo që ke rënë me një pozitë të keqe sepse askush nuk mundet me ta ndaluar se me këndë takohesh. Potencove që te ti vijën hajna, kriminel dhe qysh pe dinë që janë hajna dhe cili hajn ka qenë deri tash te ti. Në përgjigje keni potencuar se as që e kemi ditur pastaj potencon që më lajmëroj policia këto vetura a çdo herë të lajmërojnë kur i shohin katër apo pesë vetura dhe është mirë të bëni më real dhe më transparent dhe kërkoju falje qytetarëve që kam prit një kriminel këtu , nuk e kam ditur dhe nuk kam pasur njohuri për këtë për shkak se ka mundur dikush me të shtijë në lajthitje dhe është mirë me gjetur atë vijën e lajthitësve se të lajthisin përsëri.

Rufki Suma thekson:- te unë vijën plotë qytetarë të ndryshëm, policia me njofton dhe raporton për çdo send që bëhet dhe unë kisha thënë që ta thirrni kryeministrin e shtetit dhe ti thoni mos bisedoni me kriminel se kanë bërë krime në Kosovë.

Sabedin Hasallari thekson:- punimet të cilat janë duke u kryer në rrugën Hani i Elezit-Gorancë është mirë të shtrohet të paktën me zhavor si ishte vështirë për me kaluar.

Rufki Suma thekson:- e kemi njoftuar kompaninë për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:24.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSC Qamush Brava

